



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT EDUARD SULEJMANI

Nr. 44, datë 26.09.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Kleada Mersinllari	Kryesuese
Edona Dushaj	Relatore
Enton Radovan	Anëtar

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Ersila Kalaja, në datën 22.02.2024 ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Eduard Sulejmani**, me funksion aktual, Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Vlorë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji relatimin e relatores së çështjes Edona Dushaj; dëgjoji subjektin e vlerësimit, z. **Eduard Sulejmani**, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 02.02.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtorit të Kabinetit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:





I. RRETHANAT E ÇËSHTJES



1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Z. Eduard Sulejmani është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit të parë datë 05.04.2023 si Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Vlorë, në Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit .
3. Subjekti i vlerësimit, **Z. Eduard Sulejmani** nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7 datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin 1, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Edona Dushaj, **Relatore**, Znj. Kleada Mersinllari, **Kryesuese** dhe Z. Enton Radovani, **Anëtar**.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr., 1,

datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmani.

6. Relatoria e çështjes, Znj. Edona Dushaj, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 18.04.2023 duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatoria e çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit, si më poshtë vijon:
 - a. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
 - b. me shkresën nr.*** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
 - c. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ kontrollin e figurës;
 - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligji nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
- c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
- d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
- e. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2012 *** “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
- f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit që janë:

-  *Deklarata e Pasurisë,*
-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*

- h. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - i. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
 - j. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
 - k. ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.
13. Trupa e vlerësimit, më datë 19.12.2023, pasi dëgjoi relatorin, dhe krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmani , me Vendimin nr. 05, datë19.12.2023 vendosi;
- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmani ;
 - b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 -  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 -  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme , prej 5 ditëve për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2 *** “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

15. Në datën 09.09.2024, trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 13.09.2024 ora 10:30, në ambiente e sallës së mbledhjes së Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Eduard Sulejmani , u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 13.09.2023, subjekti i vlerësimi z. Eduard Sulejmani kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 26.09.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Eduard Sulejmani , ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

II. VLERËSIMI I PASURISË

16. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit

të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

17. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Eduard Sulejmanika dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 07.03.2023. Formulari i Pasurisë ka nr.1 index, viti 2023 .
18. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridik, publikë apo privatë.
20. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

21. Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- ✚ deklaraten e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

22. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;

- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

23. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2003, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport¹, të hollësishtëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Eduard Sulejmani , ku është konstatuar se:

- ✓ deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- ✓ nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ✓ nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- ✓ nuk është kryer deklarim i rremë;
- ✓ subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

A. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

24. Bazuar në nenin 34, të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nenit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së

¹ Raporti nr. ***, datë 31.07.2023, i ILDKPKI-së.

deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

III. DEKLARIM I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT, EDUARD SULEJMËN SULEJMANI DEKLARIMI I PASURIVE

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr. 1

Sipërfaqe toke 5.790 m², nga të cilat 4.250 m² tokë arë, 820 m² pemëtore dhe 720 m² ullishte në Orikum. Viti 1991. Burimi i krijimit: ligji nr.7501. Pjesa takuese 20%.

Bashkëlidhur Deklaratës

Akti i marrjes së tokës në përdorim nga familja e Eduard Sulo Sulejmani, fshati Orikum, për tokë me sipërfaqe 5.790 m², nga të cilat 4.250 m² tokë arë, 820 m² pemëtore dhe 720 m², ullishte. Akti është firmosur nga kryetari i komisionit të tokës në fshat dhe përfaqësuesi i rrethit.

Hetimi administrativ:

ASHK me shkresën ***prot., datë 20.9.2023, nuk konfirmon sipërfaqe toke në pronësi të subjektit.

ASHK online nuk konfirmon sipërfaqe toke në pronësi të subjektit.

Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit më datë 20.06.2023, subjekti ka paraqitur:

Certifikatë familjare, në përbërje të të cilës janë 5 anëtarë. Përkatësisht, nëna, babai, vëllai dhe motra e subjektit. Certifikata është lëshuar në datën 14.6.2023 dhe përmban përbërjen familjare sipas regjistrave themeltarë të vitit 1974.

Nëpërmjet email-it të datës 14.7.2023, ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti sqaron se familja bujqësore është e ndarë në dy familje: subjekti me gruan dhe djalin; dhe babai me nënën e subjektit dhe dy fëmijët e tjerë të tyre.

Subjekti paraqiti :

- Certifikatë familjare të vitit 1991, me 3 anëtarë (subjekti, bashkëshortja dhe një fëmijë);
- Certifikatë familjare të vitit 1991, të familjes prindërore me 4 anëtarë (nëna, babai, vëllai, motra).

Konstatohet:

- ✓ **Në lidhje me krijimin e kësaj pasurie trupa e vlerësimit ka realizuar kryqëzimin e informacionit të vënë në dispozicion dhe rezulton se sipërfaqja e tokës në zotërim të subjektit deklarues është përfituar nga ligji nr. 7501.**

Pasuria nr. 2

Sipërfaqe toke 5.000 m², në Nartë, Vlorë. Marrë me qira për 99 vjet nga Komuna Qendër, Vlorë, në v.2008. Qiraja mujore është 6.000 lekë në vitin kalendarik. Pjesa takuese 100%.

Bashkëlidhur Deklaratës

- Certifikatë për dhënie me qira, lëshuar nga ZVRPP Vlorë, nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, ZK ***, Nartë, Komuna Qendër, Vlorë. Afati i dhënies me qira, 99 vjet.
- Certifikata është lëshuar për të vërtetuar se qiradhënësi i mësipërm, ka dhënë me qira pasurinë e paluajtshme sipas kushteve të kontratës nr. 1371, datë 18.2.2008 dhe që z. Eduard Sulejmani është regjistruar si qiramarrës i pasurisë së mësipërme sipas kushteve të kartelës së pasurisë vol. ***, faqe ***. Data e lëshimit të certifikatës është 30.4.2009.

Hetimi administrativ:

Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit më datë 20.06.2023, subjekti sqaron “... në lidhje me marrjen me qira për 99 vjet të sipërfaqes së tokës prej 5.000 m², në Nartë, Vlorë, subjekti sqaroi se kjo sipërfaqe nuk është përdorur prej tij, ashtu siç kishte parashikuar, pasi toka ishte me shumë kripë në përbërje të saj dhe nuk ishte e përshtatshme për mbjellje apo rritjen e prodhimeve bujqësore, gjë që u provua edhe nga fqinjët, kufitarë të kësaj sipërfaqeje. Pavarësisht kësaj, detyrimet i ka shlyer rregullisht. Nga kjo procedurë e qiradhënies kanë përfituar edhe qytetarë të tjerë. Pra, nuk është një rast i shkëputur nga i cili, ai ka përfituar në mënyrë specifike...”.

Subjekti ka paraqitur:

- Kontratë qiraje nr.rep. 13 71, nr.kol. 1164, datë 18.8.2008, midis Komuna Qendër, Vlorë dhe Eduard Sulejmani, për dhënie me qira të tokës bujqësore me sip. 5.000 m2, në fshatin Nartë, komuna Qendër, Vlorë. Qiraja është në shumën 6.000 lekë në vit, për hektar.
- Kartelë e pasurisë së paluajtshme për tokë me sip. 5.000 m2, ZK ***, nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, Vlorë, Nartë, me pronësi shtet.
- Kërkesë e subjektit për marrjen e tokës me qira, datë 28.6.2008, drejtuar Komunës, Qendër, Vlorë, shoqëruar me praktikën përkatëse.
- Faturë të shlyerjes së detyrimeve si qiramarrës, për pagesa vjetore të qirasë, në shumën 12.000 lekë, shoqëruar me mandat arkëtimi për pagesë të kryer në shumën 12.100 lekë, në datën 16.6.2023.

Nëpërmjet email-it të datës 14.07.2023, të dërguar pranë ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka paraqitur vërtetim nr. ext. prot., datë 12.07.2023, lëshuar nga Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Qendër, sipas të cilit Eduard Sulejmani, nuk ka detyrime të pashlyera për tokën e marrë me qira pranë Njesisë Administrative Qendër, Bashkia Vlorë, deri në fund të vitit 2023.

Konstatohet:

- ✓ Toka — arë, me sip. 5.000 m2 në Nartë, Vlorë është marrë me qira për 99 vjet nëpërmjet kontratës së qirasë së viti 2008, me Komunën Qendër, Vlorë.
- ✓ **Shpenzime qiraje për tokën me sip. 5.000m2, në Nartë, Vlorë, nga viti 2008 — 2023, rezultojnë në shumën 43.750 lekë.**

Pasuria nr. 3

Apartament me sip. 74.28 m2, lagjja "10 Korriku", rajoni nr.2, Vlorë. Prenotuar në vitin 2010. Vlera 40.000 euro.

Burimi i krijimit: a) kredi e lehtësuar nga Bashkia, Vlorë; b) të ardhura nga shitja e objektit "ish-Magazina e NTSH, Vlorë", privatizuar e blerë në vitin 1995, nga AKP, Vlorë. Shitur në vitin 1996; c) kursime familjare. Pjesa takuese 100%.

Bashkëlidhur Deklaratës

- Certifikatë për vërtetim pronësie për apartament me sip. 74.28 m2, ZVRPP Vlorë, ZK ***, nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, në emër të Eduard Sulejmën Sulejmani. Datë e lëshimit të certifikatës 11.04.2016. Pjesa takuese 100%.

Hetimi administrativ:

ASHK sistemi online konfirmon pasuri me nr. 31/202+2-10, ZK ***, vol***, faqe ***, në pronësi të Eduard Sulejmën Sulejmani.

ASHK me shkresën m. ***prot., datë 20.9.2023, konfirmon apartament me sip. 74.28 m2, me rep. 31/202+2-10, ZK ***, vol.**, faqe ***, ne pronësi të Eduard Sulejmani. Apartamenti është hipotekuar në favor të BKT me kontratën nr. *** rep., nr. **** kol.,datë 18.11.2016. Bashkëngjitur:

- kontratë shitje nr. ****rep., nr. ****kol., datë 19.3.2016, me palë shitëse “*****”shpk dhe blerës Eduard Sulejmani, për blerjen e apartamentit me sip. 74.28 m2, me nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, ZK8602, Vlorë, në shumën 40.000 euro. Shuma e mësipërme është likuiduar sipas përcaktimeve të kontratës nr.3686 rep., nr. ***kol., datë 08.11.2010; bashkëngjitur praktika.
- Kontratë premtim shitje nr. *** rep., nr. ***kol., datë 08.11.2010, midis shoqërisë “*****”shpk, si palë shitëse e ardhshme dhe Eduard Sulejmani, si palë blerëse e ardhshme, për blerjen e apartamentit me sip. 74.28 m2, me çmim 40.000 euro. Para nënshkrimit të kësaj kontrate është likuiduar shuma prej 19.000 euro; pjesa tjetër prej 21.000 euro do të likuidohet brenda datës 31.12.2010.
- Pasqyrë bankare, ku pasqyrohet veprimi i kalimit të shumës prej 2.880.000 lekësh në datë 20.12.2010, nga llogaria e Eduard Sulejmani në atë të “*****”shpk., me përshkrimin "likuidim për blerje apartamenti "
- Mandat arkëtimi nr.13, datë. 31.01.13, për arkëtim të shumës 10.000 euro, nga Eduard Sulejmani për ****shpk. Mandat arkëtimi nr. 24, datë. 5.8.2015, për arkëtim të shumës 5.000 euro, nga Eduard Sulejmani për ****shpk.
- Mandat arkëtimi nr. 203, datë. 17.3.2014(6), për arkëtim të shumës 4.245 euro, nga Eduard Sulejmani për ****shpk.
- Kartelë e pasurisë nr. ***, vol.***, faqe ***, ZK ***, Vlorë, apartament me sip. 74.28 m2, me vlerë 40.000 euro, datë e lëshimit 11.4.2016, në pronësi të Eduard Sulejmani.
- Kontratë hipotekimi nr. 2*** rep., nr.1695 kol., datë 18.11.2016, me hipotekues Eduard me Margarita Sulejmani dhe përfitues BKT, për hipotekimin në favor të BKT, të apartamentit me sip. 74.28 m2, me nr. pasurie ***, ZK ***, vol.***, faqe ***, Vlorë, në pronësi të Eduard dhe Margarita Sulejmani, si garantues për kredinë e marrë nga Eduard Sulejmani, në shumën totale 2.931.000 lekë, sipas kontratës nr. rep. 4011, nr.kol. ***, datë 14.12.2010 dhe anekseve bashkëngjitur kësaj kontrate.

BKT me email të datës 25.5.2023, konfirmon kredi në emër të Eduard Sulejmani disbursuar në 17.12.2010, në shumën 2.901.690 lekë, transferuar në datën 20.12.2010, 2.880.000 lekë, në llogarinë e ****shpk, për likuidim apartamenti.

Në procesverbalin e datës 20.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti në lidhje me apartamentin me sip. 74.28 m2, paraqiti:

- Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2010, me kredi dhënës BKT dhe kredi marrës Eduard Sulejmani, për akordimin e kredisë në shumën 2.931.000 lekë, në favor të Eduard Sulejmani; kohëzgjatja 228 muaj, për blerje apartamenti. Kredia i akordohet subjektit si pjesë e listës që i është vënë në dispozicion bankës nga institucioni kualifikues i përfituesit.
- Aneks i çeljes dhe përdorimit të kredisë, datë 14.12.2010, midis BKT si kredi dhënës dhe Eduard Sulejmani, si kredi marrës ku palët bien dakord që shuma që do të disbursohet në llogarinë e kredisë, të jetë 2.931.000 lekë; kreditimi do të përdoret për blerje shtëpie.
- Aneks i elementeve specifike të kredisë, datë 14.12.2010, midis BKT si kredi dhënës dhe Eduard Sulejmani, si kredi marrës të cilët bien dakord që shuma e kredisë, e miratuar nga Banka, prej 2.931.000 lekësh, do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të apartamentit dhe shuma do të transferohet në llogarinë e ****shpk, nëpërmjet BKT.
- Kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2010, nga ana e A.S dhe S.S, i apartamentit me sip. 63.65 m2, ZK ***, vol. *** faqe ****, nr. pasurie ****, Vlorë, për BKT, si garantues për kredinë e përfituar nga Eduard Sulejmani.
- Aneks i kontratës së kredisë, datë 18.11.2016, midis BKT dhe Eduard e Margarita Sulejmani, për hipotekimin në favor të BKT, të apartamentit me sip. 74.28 m2, me nr. pasurie 31/202+2-10, ZK ***, vol. 44, faqe 190, Vlorë, në pronësi të Eduard dhe Margarita Sulejmani, si garantues për pjesën e mbetur të kredisë së përfituar në vitin 2010.
- Kontratë hipotekimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.11.2016, me hipotekues Eduard me Margarita Sulejmani dhe përfitues BKT, për hipotekimin në favor të BKT, të apartamentit me sip. 74.28 m2, me nr. pasurie ***, ZK ***, vol.***, faqe ***, Vlorë, në pronësi të Eduard dhe Margarita Sulejmani, si garantues për kredinë e marrë nga Eduard Sulejmani, në shumën totale 2.931.000 lekë, sipas kontratës nr.rep. ***, nr.kol. ***, datë 14.12.2010 dhe anekseve bashkëngjitur kësaj kontrate.
- Vërtetim nga BKT, datë 17 gusht 2015, sipas të cilit Eduard Sulejmani është përfitues i një kredie në vlerën 2.931.000 lekë, sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2010, sipas ligjit nr.9332, datë 13.4.2004 "Për programet Sociale të Strehimit për banorët e zonave urbane ". Për kredinë e përfituar është lënë kolateral apartament me sip. 63.652 m2, ZK ***, vol. *** faqe ****, nr. pasurie ****, Vlorë, në pronësi të A.S dhe S.S.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., datë 21.6.1996, midis Eduard Sulejmani dhe K.M, shitës, K.T e C.R, blerës, për objektin magazinë, me sip. 320 m2, në shumën 75.000.000 lireta.

Në procesverbalin e datës 28.09.2023,të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit, subjekti është shprehur “... në lidhje me dokumentet, mandat arkëtimet, e vëna në dispozicion nga ASHK, për pagesa të kryera në favor të kompanisë "*****"shpk, për blerjen e apartamentit me sip. 74.28 m2, nga ana e tij, sqaroi se këto mandate i ka firmosur për të patur një dokument zyrtar për pagesën e kryer dhe sikurse shihet, vlera totale e tyre është 19.000 euro.

*Pagesën e shumës 19.000 euro për apartamentin e ka kryer para nënshkrimit të kontratave me ****shpk, sikurse është e shprehur edhe në dokumentet përkatëse, të paraqitura nga ana e tij në ILDKPKI. Në të njëjtën mënyrë është shprehur edhe BKT, në dokumentet e nënshkruara prej tij për disbursimin e kredisë, ku është shënuar se me këtë shumë, do të likuidonte pjesën e mbetur të çmimit të apartamentit... ”.*

Trupa e Vlerësimit me email-in e datës 29.05.2024 ka pyetur subjektin e vlerësimit për mos deklarinimin e kësaj pasurie si dhe për burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Subjekti i vlerësimit me email-in e datës 06.03.2024 ka sqaruar se: “ ... Përfitur me kredi të lehtësuara nga Bashkia Vlorë, në vlerën 2.931.000 (Dy milion e nëntëqind e tridhjetë e një mijë) lekë.

Pjesa tjetër e shumës është plotësuar nga të ardhurat nga shitja e objektit “ish Magazina e NTSH Vlorë”, privatizuar e blerë në vitin 1995, nga AKP Vlorë dhe shitur në vitin 1996, si dhe nga kursime nga të ardhurat familjare ndër vite.

(Nuk jam në gjendje ta ndaj saktësisht sa është vlera e përdorur nga shitja e objektit “ish Magazina e NTSH Vlorë” dhe sa nga kursimet familjare) ... ”

Konstatohet se:

- ✓ *Faturat e arkëtimit ne total prej 19000 euro, të paraqitura nga subjekti i vlerësimit nuk përputhen me Kontratën e premtim shitje nr. *** rep., nr. ***kol., datë 8.11.2010, midis shoqërisë “*****”shpk, si palë shitëse e ardhshme dhe Eduard Sulejmani, si palë blerëse e ardhshme, për blerjen e apartamentit me çmim 40.000 euro.*
- ✓ *Subjekti i vlerësimit nuk specifikon vlerat përkatëse të burimeve të krijimit për blerjen e këtij apartamenti, si dhe nuk paraqet dokumentacion justifikues lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, prandaj Trupa e Vlerësimit merr në konsideratë si burim të ligjshëm te kësaj pasurie vetëm të ardhurat e krijuara nga kredia bankare.*

Pasuri nr. 4

- Llogari në Raiffeisen Bank me gjendje 69. *** euro. Burimi i krijimit: shitja e apartamentit me sip. 84.5 m2, në lagjen “****”, rruga “****”, Rajoni nr.3, Vlorë. Sipas kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. rep. ***, nr.kol. ***, datë 17.10.2022. Pjesa takuese 100%.

Hetimi administrativ:

- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. rep. ***, nr.kol. ***, datë 17.10.2022, për shitjen nga Eduard dhe Margarita Sulejmani, të apartamentit me sip. 84.5 m2, me nr.pasurie ***, ZK ***, vol. ***, faqe ***, Vlorë, me çmim të shitjes 70.000 euro; me blerës F.T. Vlera prej

70.000 euro do të derdhet nga pala blerëse në llogarinë rrjedhëse të zyrës noteriale, nëpërmjet Alpha Bank, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.

- Certifikatë për vërtetim pronësie për apartament me sip. 84.5 m2, ZK ***, nr.pasurie ***, vol. ***, faqe ***, Vlorë, në pronësi të Eduard Sulejmani; lëshuar në datë 21.5.2007.
- Kartelë e pasurisë së paluajtshme për apartament me sip. 84.5 m2, ZK ***, nr.pasurie ***, vol. ***, faqe ***, Vlorë, në pronësi të Eduard Sulejmani, ku është shënuar vlera fillestare e apartamentit në shumën 2.500.000 lekë dhe pas rivlerësimit në shumën 65.400.000 lekë (akti nr. ***, datë 04.12.2013); akti i fitimit të pronës (kontratë shitje nr.***, e regjistruar në ZVRPP në datë 1.6.2004). Bashkëngjitur praktika e plotë.
- Vlera e apartamentit pas rivlerësimit e shënuar 65.400.000 lekë është korrigjuar në një nga dokumentet e konfirmuara nga ASHK Vlorë; si edhe është e shënuar 6.540.000 lekë në 2 dokumente të konfirmuara nga ASHK
- Vërtetim nga Raiffeisen Bank, ku rezulton llogari në emër të Eduard Sulejmani, çelur në datë 17.11.2022, me gjendje 69. *** euro, në datën 28.02.2023.

Raiffeisen Bank me shkresë nr. ***prot., datë 08.05.2023, konfirmon depozitë në emër të Eduard Sulejmani, me gjendje në datën 28.02.2023, në shumën 69. *** euro.

ASHK me shkresë nr.***prot., datë 20.9.2023, konfirmon apartament me sip. 84.5 m2, me nr. ***, ZK***, vol. ***faqe ***, të ketë qenë në pronësi të Eduard Sulejmani. Pasuria, në datën 27.10.2022 ka kaluar në pronësi të F.T dhe D.T

- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.3.2003, me palë shitëse M.A(***) dhe palë blerëse Eduard Sulejmani për blerjen e apartamentit me sip. 84.5m2, në shumën 2.500.000 lekë. Shuma është likuiduar nga pala blerëse para nënshkrimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale.
- Kartelë e pasurisë së paluajtshme për apartament me sip. 84.5 m2, me nr. ***, ZK ***, vol. ***, faqe ***, në pronësi të Eduard Sulejmani, lëshuar në datë 04.10.2022,
- Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. rep. ***, nr.kol. ***, datë 17.10.2022, me palë shitëse Eduard dhe Margarita Sulejmani dhe palë blerëse F.T për shitje të apartamentit me sip. 84.5 m2, me nr. pasurie ***, ZK ***, vol. ***, faqe ***, Vlorë, me çmim të shitjes 70.000 euro. Vlera prej 70.000 euro do të derdhet nga pala blerëse në llogarinë rrjedhëse të zyrës noteriale, nëpërmjet Alpha Bank, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës.
- Pasqyrë nga Alpha Bank, e transaksionit të kalimit të shumës prej 70.000 euro në datën 17.10.2022, nga F.T në llogarinë e noteres J.V, nëpërmjet Alpha Bank.

Në procesverbalin e datës 20.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe të administruar nga Trupa e Vlerësimit , në lidhje me burimin e blerjes së apartamentit me sip. 84.5 m2 subjekti paraqiti:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep., datë 21.06.1996, midis Eduard Sulejmani dhe K.M, shitës dhe K.T e C.R, blerës, për shitjen e objektit magazine, me sip. 320 m2, në shumën 75.000.000 lireta.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep., datë 11.04.1996, midis përfaqësues të NTSH 1 R.Mshitës dhe A.N, P.M, A.B, Eduard Sulejmani dhe K.M, blerës, për magazine me sip.320 m2, në shumën 1.607.829 lekë. Kjo shumë është shlyer nëpërmjet mandatpagesave dhe një urdhër xhirimi me bono privatizimi në vlerën 1.400.000 leke, në degën e Bankës Tregtare Agrare Vlorë.
- Kontratë shitblerje nr. 1*** rep., datë 11.04.1996 midis A.N, P.M dhe A.B, shitës dhe Eduard Sulejmani e K.M, blerës, të pjesëve takuese në objektin magazine, në shumën 1.500.000 leke; sipërfaqja e përgjithshme e magazinës është 320 m2.

Në procesverbalin e datës 14.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit, në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit, subjekti sqaroi se: “... deri në vitin 2003 ka jetuar me prindërit në Orikum. Të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës i kanë patur të përbashkëta. Po kështu kanë patur edhe ndihmë për prindërit nga vëllai në emigracion”.

Trupa e vlerësimit referuar deklaramit të mësipërm të subjektit të vlerësimit zhvilloi një hetim të hollësishëm mbi burimin dhe mundësinë e krijimit të kësaj pasurie, të bazuar në prova dhe faktet e dorëzuara nga subjekti i vlerësimit, si dhe duke marrë korrespondence me institucionet ligj zbatuese në vend dhe bankat e nivelit të dytë nga ku me konkretisht:

Trupa e Vlerësimit me emai-lin e datës 29.05.2024 ka pyetur subjektin i vlerësimit për mos deklaramin e kësaj pasurie si dhe për burimin e krijimit të kësaj pasurie.

Subjekti i vlerësimit me email-in e datës 06.03.2024 ka sqaruar se : “... Lidhur me këtë, ju informoj se nuk kam patur si qëllim që të fsheh apo shmang deklaramin, por në momentin e deklaramit të pasurisë nuk e kam disponuar si pronë, pasi e kisha shitur dhe kam gjykuar që duhej deklaram vetëm gjendja konkrete, duke deklaram vlerën e shitjes së apartamentit, të gjendur në bankën Raiffeisen Bank.

Në deklaramin e thelluar të pasurisë pranë ILDKPI, kam bërë deklaramin e plotë të blerjes dhe shitjes, të kontratave përkatëse, si dhe të burimit të atëhershëm të krijimit të kësaj pasurie...”

Konstatohet se:

- ✓ *Subjekti i vlerësimit nuk specifikon vlerat përkatëse të burimeve të krijimit për blerjen e këtij apartamenti, si dhe nuk paraqet dokumentacion justifikues lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, prandaj Trupa e Vlerësimit merr në konsideratë si burim të ligjshëm e kësaj pasurie vetëm të ardhurat e krijuara nga shitja e magazinës me kontratë shitblerje nr. *** rep., datë 21.06.1996.*

Pasuria nr. 5

Truall me sipërfaqe 640 m2 (1/3 pjesë e sipërfaqes prej 1.920 m2) në zonën ***-***, Sarandë, Vlera 512.000 lekë. Blerë me kontratë shitblerje me komunën ***Sarandë, në datën 03.10.2001, secili nga 512.000 lekë.

Burimi i krijimit: të ardhurat familjare ndër vite. Pjesa takuese 33 %.

Bashkëlidhur Deklaratës

Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.10.2001, midis Komuna ***dhe Eduard Sulejmani, K.D, H.H , për blerje të një sipërfaqe trualli prej 1.920 m2, në zonën ***-***, me çmim 1.536 000 lekë. Pronësia e shitësve bazohet në vendimin e këshillit të Komunës ***nr. ***, datë 4.5.2001, vendimin e KIRT nr. 1, datë 26.4.2000 dhe në sheshin e ndërtimit që individualizon pronën. Pagesa është kryer nëpërmjet bankës, me dokumentin nr. ***, datë 2.10.2001. ASHK sistemi online nuk e konfirmon pasuri këtë pasuri në pronësi të Eduard Sulejmani.

Hetimi administrativ:

ASHK me shkresë nr. ***prot., datë 20.9.2023, nuk konfirmon sipërfaqen truall 640 m2, në pronësi të Eduard Sulejmani.

Në procesverbalin e datës 20 qershor 2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit, në lidhje me këtë sipërfaqe toke subjekti sqaroi se “... e kishin blerë për të ndërtuar një bar- hotel — restorant siç duket edhe nga dokumentet e paraqitura. Ky investim nuk u krye, pasi kur aplikuan për regjistrimin e pronës në ZVRPP, rezultoi që kjo pronë ishte e regjistruar në emër të një komuniteti fetar. Për këtë arsye, do të fillojnë një procedurë gjyqësore për zgjidhjen e problemit. Ndërkohë, për deklarimin e pjesës takuese në 33%, sqaroi se në kontratën e blerjes nuk është shprehur në mënyrë eksplicite kjo gjë, pasi është marrë e mirëqenë nga ana e të tre blerësve. Po kështu, kanë patur edhe kontributin financiar, në mënyrë të barabartë, secili në 1/3 e shumës së përgjithshme. Nëse do të kishin pjesë dhe kontribute të ndryshme financiare në këtë pronë, do t' i kishin përcaktuar konkretisht në kontratat përkatëse. Në lidhje me statusin e blerjes së kësaj sipërfaqeje toke, shtoi se gjithë procedura e ndjekur për blerjen e saj është e rregullt, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, që ndiqej nga komuna edhe në rastet e tjera...”.

Subjekti paraqiti:

- Vendim i KRRT të rrethit Sarandë, nr. 1, datë 26.04.2000, për miratimin e sheshit të ndërtimit me sip. 1.920 m2, për objektin hotel-bar-restorant, ***.

- Vendim nr. ***, prot. 5, datë 4.7.2001, i Komunës ***për dhënien e sheshit të ndërtimit me sip. 1.920 1112, Eduard Sulejmani, K.D, H.H për ndërtim me sip. 768 m2.
- Akt vlerësimi trualli me sip. 1.920 m2, nga ana e seksionit të urbanistikës, me vlerën 1.536.000 lekë.
- Mandat i kryerjes së pagesës në shumën 1.536.000 lekë, nëpërmjet Bankës së Kursimeve për Bashkinë Sarandë, nga ana e Eduard Sulejmani, K.D, H.H , në datë 02.10.2001.
- Prokurë e posaçme nr.rep. ***, nr.kol. ***, datë 25.3.2022, lëshuar nga Eduard Sulejmani, K.D, H.H për avokat Çlirim Shahini, për të kryer në emër dhe interes të tyre procedura ligjore pranë autoriteteve shqiptare.
- Vërtetim datë 13.06.2023, i Avokat Çlirim Shahini, për pajisjen me prokurë nga ana e Eduard Sulejmani, K.D, H.H , për të ndjekur procedurat gjyqësore, për kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Çështja është në fazën e grumbullimit të dokumentacionit.

Pasuria nr.6

Llogari page në Raiffeisen Bank, me gjendje 64.187 lekë. Pjesa takuese 100%.

Hetimi administrativ:

Raiffeisen Bank me shkresë nr. ***prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari page ku janë kredituar të ardhurat nga paga, me gjendje në shumën 5.731 lekë, datë 28.02.2023.

Konstatohet se:

Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

Subjekti i vlerësimit Eduard Sulejmani ka dhënë këto deklarime të ardhurave në vite:

- Të ardhura nga paga, në Policinë e Shtetit, Reparti 751 FNSH Vlorë, për periudhën 16.09.1992 - 31.03.1996, përfaqësisht në shumën 150.000 lekë. Nuk disponohet dokumentacioni pasi është djegur në v. 1997. Sipas dokumentit lëshuar nga Reparti Special për Kufirin dhe Migracionin, DELTA, Vlorë (ish-reparti 751 FNSH, Vlorë).
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, Reparti 751 FNSH Vlorë, për periudhën 01.04.1996 - 23.09.2000. Shuma ***7.980 lekë. Sipas dokumentit lëshuar nga Reparti Special për Kufirin dhe Migracionin, DELTA, Vlorë (ish-reparti 751 FNSH, Vlorë).
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, Komisariati i Policisë, Sarandë, DVQ Vlorë, për periudhën 24.9.2000 — 27.5.2002. Shuma 447.204 lekë. Sipas dokumentit lëshuar nga Komisariati i Policisë, Sarandë.

- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, Komisariati i Policisë, Gjirokastrë, DVQ Gjirokastrë, për periudhën 28.05.2002 - 30.11.2002. Shuma 218.881 lekë. Sipas dokumentit lëshuar nga DPV, Gjirokastrë.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, Komisariati i Policisë, Vlorë, DVQ Vlorë, për periudhën 01.12.2002 - 30.11.2003. Shuma 476.519 lekë. Sipas dokumentit lëshuar nga DPV, Vlorë.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, DVQ Fier, për periudhën 01.12.2003 - 31.03.2004. Shuma ***.278 lekë. Sipas dokumentit lëshuar nga DPV, Fier.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, DVQ Vlorë, për periudhën 01.04.2004 - 03.01.2004. Shuma 334.296 lekë. Sipas dokumentit lëshuar nga DPV, Vlorë.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit, për periudhën 1.1.2003 - 28.2.2003. Shuma 18.732.680 lekë.

Hetimi administrativ :

Vërtetim nr. * prot., datë 6.3.2023 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**, ku rezulton se Eduard Sulejmani ka përfituar të ardhura neto për vitin 1996 në shumën 129.070 lekë; për vitin 1997, në shumën 167.900 lekë; për vitin 1998, në shumën 192.350 lekë; për vitin 1999, në shumën 268.880 lekë; dhe për vitin 2000, në shumën 189.780 lekë. Në total, të ardhura, për periudhën 1996 — 2000, në shumën ***7.980 lekë.

Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, vulosur nga Komisariati i Policisë, Sarandë, ku rezulton se Eduard Sulejmani, për periudhën tetor 2000 — maj 2002, ka realizuar të ardhura neto, në shumën 447.204 lekë.

Vërtetim datë 7.3.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, ku rezulton se Eduard Sulejmani ka përfituar të ardhura neto nga paga, për periudhën qershor 2002 — nëntor 2002, në shumën 218.881 lekë.

Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nga Drejtoria Vendore e Policisë, Vlorë, ku rezulton se Eduard Sulejmani, për periudhën dhjetor 2002 — dhjetor 2003, ka realizuar të ardhura neto nga paga në shumën 476.519 lekë.

Vërtetim datë 3.3.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, ku rezulton se Eduard Sulejmani, për periudhën 1.12.2003 — 31.3.2004, ka përfituar të ardhura neto nga paga, në shumën ***.278 lekë.

Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, nga Drejtoria Vendore e Policisë, Vlorë, ku rezulton se Eduard Sulejmani për periudhën 1.4.2004 - 31.12.2004, ka realizuar të ardhura neto nga paga në shumën 334.296 lekë.

Vërtetim nga RFZ Bank, ku janë kredituar të ardhurat nga paga për Eduard Sulejmani, në shumën 18.732.680 lekë, për periudhën 2 *** — 2023.

Raiffeisen Bank me shkresë nr. ***prot., datë 8.5.2023, konfirmon llogari page në emër të Eduard Sulejmani, në të cilën kreditohen të ardhurat nga paga për periudhën 3.5.2 *** - 28.2.2023 në shumën 18.732.666 lekë, nga Policia e Shtetit.

ISSH me shkresë nr. ***prot., datë 10.5.2023, konfirmon se Eduard Sulejmani ka përfituar të ardhura/neto nga paga, për periudhën 3.7.1981 — 26.12.1983 dhe 3.2.1986 nga NB Rinia Vlorë; për periudhën janar 2012 — mars 2023, në shumën 11.755.028 lekë nga Policia e Shtetit.

DETYRIMET FINANCIARE

Subjekti vlerësues Eduard Sulejmani ka dhënë këto deklarime të detyrimeve në vite:

Detyrimi nr.1.

- Kredi në BKT, dega Vlorë, në shumën 2.931.000 lekë, me këst mujor 16.942 lekë. Qëllimi: blerje e apartamentit. Sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2010. Gjendje në datë 28.02.2023, shuma 1.266.733 lekë

Hetimi administrativ :

Email nga BKT, Vlorë, datë 09.03.2023, ku rezulton se detyrim i mbetur për kredinë, në datën 28.2.2023 është shuma 1.266.733 lekë.

BKT me email datë 25.5.2023, konfirmon kredi në emër të Eduard Sulejmani me gjendje detyrimi në datë 28.02.2023, në vlerën 1.266.733 lekë.

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se në llogari të subjektit të vlerësimit janë depozituar në mënyre periodike vlera të ndryshme nga shtetasit A.C, E.A, M.M, E.SH, R.F..

Trupa e vlerësimit me email-in e datës 29.05.2024 i ka kërkuar subjektit të jap për marrëdhëniet e tij me këta personat?

Subjekti i vlerësimit me email e datës 03.06.2024 shprehet se “...Shtetasi A.C., është punonjës në bankën BKT Vlorë, mik familjar i imi. Shtetasi E.A , punonjës policie në DVKM Vlorë, shoferi im. M.M, mendoj se është gabim ky mbiemër, duke gjykuar se bëhet fjalë për bashkëshorten time të quajtur Margarita Sulejmani. E.SH , sipas informacionit që mora, është punonjës në bankën Raiffeisen Bank, dega Lushnje, nuk kam asnjë njohje, as për fytyrë me të, por mendoj se duke qenë punonjës aty ka kryer ndonjë detyrë të ngarkuar nga Drejtori i kësaj banke (shih sqarimin në pikën

më poshtë), i cili është fis i nënës time. R.M , është Drejtor në bankën Raiffeisen Bank, dega Lushnje, fis i nënës time dhe mik i afërt familjar...”

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur, Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Shpenzime për pagesën e detyrimit për energjinë elektrike, për periudhën 12-mujore, 1 mars 2022 — 28 shkurt 2023. Shuma 148.633 lekë.
- Shpenzime për pagesën e detyrimit për ujin e pijshëm, për periudhën 12-muj ore, 1 mars 2022 - 28 shkurt 2023. Shuma 28.672 lekë.
- Shpenzime telefonike të subjektit, për dy numra telefoni në përdorim, për periudhën 12mujore, 1 mars 2022 — 28 shkurt 2023. Shuma 12.000 lekë.
- Shpenzime telefonike të personit të lidhur me subjektin, bashkëshortes së subjektit, Margarita Sulejmani, për periudhën 12-mujore, 1 mars 2022 — 28 shkurt 2023. Shuma 7.200 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

Përgjigje për kërkesë të kryer nga Eduard Sulejmani, lëshuar nga FSHU, Vlorë, nr. ***prot., datë 6.3.2023, ku rezulton se kontratat FIOA***, FIOB***, FIOA***, janë në emër të Eduard Sulejmani. Bashkëngjitur faturat e pagesave përkatëse, që në total, për periudhën 12-mujore, shkurt 2022 —janar 2023, janë në shumën 148.633 lekë.

Përgjigje për kërkesë të kryer nga Eduard Sulejmani, lëshuar nga UK, Vlorë, nr. 523 prot., datë 6.3.2023, ku rezulton se në emër të Eduard Sulejmani janë tre kontrata për furnizimin me ujë të pijshëm, konkretisht:

1. Eduard Sulejmën Sulejmani me nr. klienti ***, zona 6, në kabinën "Skela Konstruksion " me adresë: Lagjja "**** rruga ****", Vlorë,'
2. Edi Fiqirete Sulejmani, me nr. klienti ***, zona Orikum, Vlorë, kabina fshati Orikum, me adresë: fshati Orikum, Vlorë,
3. Eduard Sulejmani, me nr. klienti ***, në kabinën***, me adresë: Lagjja "10 Korriku", rruga "Çamëria", Vlorë. Bashkëlidhur faturat e pagesave përkatëse, për periudhën 12-mujore, shkurt 2022 — janar 2023, me vlerë totale 32.796 lekë.

Hetimi administrativ :

FSHU me shkresë nr. ***prot., datë 19.05.2023, konfirmon se me gjeneralitetet; Eduard Sulejmën Sulejmani, për periudhën deri në 28.02.2023, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë tëfurnizimit me energji elektrike me FSHU; Margarita Qemal Sulejmani, për periudhën

deri në 28.02.2023, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike me FSHU;

Margarita Sulejmani, për periudhën deri në 28.02.2023, rezulton 1 abonent me kontratë të furnizimit Nr. TR***, në instancën, Tiranë;

Bruno Eduard Sulejmani, për periudhën deri në 28.02.2023, nuk rezulton të jetë abonent dhe të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike me FSHU.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës — Kanalizime Vlorë, me shkresë nr. 28/46 prot., datë 29.05.2023, konfirmon se në emër të Eduard Sulejmën Sulejmani është regjistruar kontrata nr. 27267, me numër klienti ***, me adresë: Lagjja "**** rruga "****Vlorë. Për vitin 2022, ky abonent ka paguar shumën 14.562 lekë. 14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjetllës — Kanalizime, me shkresat nr. ****prot, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Vodafone Albania sh.a., me shkresë nr. ***prot., datë 13.7.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë kryer pagesa për numrat e telefonit në dispozicion, konkretisht: Eduard Sulejmani për numrin 0695638259 dhe Margarita Sulejmani për numrin 0697910915 për vitin 2022, në shumën 26.***8 lekë.

One Albania sh.a me shkresën nr. ***prot., datë. 7.6.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të kenë numra të regjistruar në rrjetin ONE Albania.

Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. ***prot, datë 15.5.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Abissnet sh.a me shkresën m. ***prot., datë 11. 5.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të. Digicom sh.a, me shkresën nr.28/52 prot., datë 12.5.2023, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Në procesverbalin e datës 13.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti në lidhje me informacionet e ardhura nga FSHU dhe UK Vlorë, sqaroi: “... kontrata në emër të Edi Fiqirete Sulejmani, me nr.klienti ***, zona Orikum Vlorë, kabina fshati — Orikum, me adresë: fshati Orikum, Vlorë, i përket shtëpisë së prindërve të tij. Është bërë me dy emra, të subjektit dhe nënës së tij dhe pagesat kryhen prej tij.

*Kontrata në emër të Eduard Sulejmën Sulejmani me nr. klienti ***, zona 6, në kabinën "**** "me adresë: Lagjja "**** rruga "****", Vlorë; i takon apartamentit të shitur në fund të v. 2022. Deri në nëntor 2022, për këtë apartament ka shlyer detyrimet ndaj UK Vlorë, për ujin e pijshëm të konsumuar.*

*Kontrata e lidhur në emër të ****Eduard Sulejmani, me nr. klienti ***, në kabinën****, me adresë: Lagjja "10 Korriku rruga "Çamëria", Vlorë; i takon apartamentit që ka në pronësi.*

Edhe në lidhje me kontratat e lidhura me FSHU është i njëjti shpjegim, pra i takojnë respektivisht shtëpisë së prindërve të tij; apartamentit të shitur si edhe apartamentit që ka në pronësi, në Vlorë...”

Në lidhje me informacionin e ardhur nga FSHU, për një kontratë në emër të Margarita Sulejmani, në Tiranë, sqaroi “... dhe deklaroi në përgjegjësinë e tij personale se nuk ka patur asnjëherë dhe nuk ka një kontratë të tillë në emër të bashkëshortes. Ata si familje nuk kanë dhe nuk kanë patur asnjë pronë në Tiranë apo diku tjetër, përveç sa ka deklaruar në Deklaratën Vetting...”

Konstatohet se:

- ✓ **Shpenzimet e deklaruara për ujë + drita + telefoni + internet gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, rezultojnë në total rreth 208.000 lekë.**
- ✓ **Shpenzime për pagesën e detyrimit për energjinë elektrike me OSHE për vitin 2022. Kontrata nr. TR2A020107162692. Shuma 82.555 lekë.**
- ✓ **Shpenzime për pagesën e detyrimit për ujë. UKT për vitin 2022. Zona 1-B2. Kontrata 123109-1. Shuma 26.822 lekë.**
- ✓ **Pagesa për internet, telefon dhe akses në kanalet TV IPTV. Shuma 31.317 lekë.**
- ✓ **Telefon celular me ofertë 500 lekë/muaj =500 internet pa limit. Shuma 12.000 lekë.**
- ✓ **Telefon celular me parapagim . Shuma 12.000 lekë.**
- ✓ **Telefoni i bashkëshortes. Shuma 6.000 lekë.**

Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 — 31.12.2022.

Subjekti nuk ka deklaruar shpenzime.

Hetimi administrativ :

Nëpërmjet email të datës 23.06.2023, dërguar pranë ILDKPKI-së, subjekti paraqiti një listë të hyrje daljeve nga vendi, nga sistemi TIMS, për periudhën 2020 — 2022

Në proces verbalin e datës 29.06.2023 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti sqaroi në lidhje me shpenzimet e kryera,

Udhëtime për vitin 2020:

1. Datë 07.03.2020 — 08.03.2020, udhëtim në Mal të Zi, me bashkëshorten, rreth 5.000 lekë.

2. Datë 23.08.2020 — 24.08.2020, udhëtim në Maqedoni, djali, Bruno Sulejmani rreth 50 euro.

Udhëtime për vitin 2021:

1. Datë 17.08.2021 — 24.08.2021, udhëtim në Antalia, djali Bruno Sulejman, rreth 640 euro.

Udhëtime për vitin 2022:

1. Datë 11.02.2022 (hyrje) djali, Bruno Sulejmani.

Në procesverbalin e datës 28.08.2023 të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti në lidhje me shpenzimet e kryera për udhëtime private jashtë vendit sqaroi se: *“...udhëtimin me bashkëshorten në Mal të Zi, për një ditë, shpenzimet kanë qenë minimale, ndoshta rreth 5.000 lekë. udhëtimin e djalit në Antalia, shpenzimi ka qenë në shumën rreth 640 euro...”*

Përsa i përket hyrjes së djalit, Bruno Sulejmani, pasqyruar në datën 11.02.2022, sqaroi se:

*“... në këtë datë ka hyrë automjeti i tij i blerë në Itali (Automjet Ford Kuga, me targë AB***FL, nr. shasie ***, viti i prodhimit 2010. Blerë në datë 9.2.2022. Vlera 2.000 euro), me kontratë blerje me kartën e tij të identitetit, dhe hyrja në Portin e Durrësit është regjistruar me kartën e tij. Djali nuk ka qenë në Itali në atë periudhë. Për këtë arsye nuk është pasqyruar në dokumentin e TIMS, dalje e djalit nga Shqipëria...”*

Në procesverbalin e datës 14.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit në lidhje me shpenzimet e kryera nga djali në udhëtimin një-ditor të datës 23.08.2020 — 24.08.2020, në Maqedoni subjekti deklaroi se: *“... shpenzimet mund të kenë qenë rreth 50 euro...”*

Për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas Periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit - Periudha nga data e (fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrës Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të' deklaramit të pasurisë:

- Shpenzime për arsimin e djalit në Shkollën e Lartë "****" Vlorë, Bachelor, për periudhën shkollore 2013 - 2014; 2014 - 2015; 2015 - 2016. Shuma 4.500 euro (1.500 euro për çdo vit shkollor).
- Shpenzime për arsimin e djalit në Universitetin Evropian të Tiranës, Master, për periudhën shkollore 2016 — 2017; 2017 — 2018. Shuma 3.000 euro. (1.500 euro për çdo vit shkollor).
- Shpenzime për arsim të subjektit, Eduard Sulejmani, për kryerje të shkollës së lartë, dega Drejtësi, në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në Maqedoninë e Veriut, për periudhën 2009 - 2012. Shuma 1.800 euro. (600 euro për çdo vit shkollor).

Në datën 20.06.2023 në lidhje me shpenzimet e deklaruara për shkollimin e djalit, Bruno Sulejmani, subjekti paraqiti në Protokollin e ILDKPKI:

- 9 kopje të mandateve të arkëtimit të shumave prej 500 euro, për Universitetin ***, në Vlorë;
- 1 kopje të mandat arkëtimi për UET Tiranë, në shumën 1.250 euro, të datës 28. 07.2016.

Trupa e vlerësimit me email-in e datës 29.04.2024 ka pyetet subjektin në lidhje me vend banimin e djalit të tij, shtetasi Bruno Sulejmani gjatë periudhës së kryerjes së studimeve në tiranë

Subjekti i vlerësimit me email-in e datës 03.06.2024 ka sqaruar "...gjatë periudhës tetor 2016 deri në muajin maj 2022, që djali im Bruno Sulejmani, ka qëndruar në Tiranë, është akomoduar në apartamentin në përdorim nga vajza e tezes time dhe familja e saj, e quajtur Donika Maliqi."

TË DHËNA KONFIDENCIALE

Sipërfaqe trualli 640 m2 (1/3 pjesë e sipërfaqes 1.920 m2, në zonën *** — ***, Sarandë, blerë me kontratë të shitblerjes me komunën ***Sarandë, datë 03.20.2001 secili nga 512.000 lekë. Bashkëpronarë në pjesë të barabarta janë K.D dhe H.H , secili me nga 1/3 pjesë të kësaj prone. Kontratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 03.10.2001, noter Thoma Kaçi, Sarandë. Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat familjare në vite. Shënim: Kjo sipërfaqe nuk është hipotekuar, pasi ndodhej në zonë të pastudiuar dhe sipas verifikimeve ka mbivendosje me një pronë të Komunitetit Bektashian Shqiptar, të cilët e kanë regjistruar pronën në ZVPP Sarandë. Për shkak të mos hipotekimit të kësaj prone, aktualisht jemi në procedurë gjyqësore për marrjen nga ana jonë të shumës së paguar për blerjen e kësaj sipërfaqeje toke.

Trajtuar më sipër.

DEKLARIM I BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT MARGARITA SULEJMANI **DEKLARIMI I PASURIVE**

Pasuria nr. 1.

- Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank, me gjendje në 28.02.2023, në shumën 1.546 lekë. Pjesa takuese 100%.

Hetimi administrativ:

Raiffeisen Bank me shkresën nr. ***prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari page në emër të Margarita Sulejmani ku janë kredituar të ardhurat nga paga, me gjendje në shumën 358 lekë, datë 28.02.2023.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga, nga Policia e Shtetit, DVQ Fier, trajtuar si pagë bashkëshorteje, në periudhën 01.01.2004 — 31.03.2004. Shuma 26.691 lekë. Sipas dokumentit lëshuar nga DPV, Fier.
- Të ardhura nga paga, nga Policia e Shtetit, DVQ Vlorë, trajtuar si pagë bashkëshorteje, në periudhën 1.4.2004 — 31.12.2004. Shuma 120.600 lekë. Sipas dokumentit lëshuar nga DVP, Vlorë.
- Të ardhura nga paga, në periudhën 01.01.2006 — 28.02.2023, trajtuar si pagë bashkëshorteje dhe nga viti 2006 e në vijim si punonjëse e sistemit arsimor. Shuma 8.330.376 lekë. Sipas dokumentit lëshuar nga RFZ Bank.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim datë __03.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, ku rezulton se Margarita Sulejmani, për periudhën 1. 12004 — 31.3.2004, është trajtuar me pagë si bashkëshorte, në shumën 26.691 lekë.
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Vlorë, ku rezulton se Margarita Sulejmani për periudhën 1.4.2004 — 31.12.2004, ka realizuar të ardhura neto nga paga në shumën 120.600 lekë.
- Vërtetim nga Raiffeisen Bank, ku janë kredituar të ardhurat nga paga për Margarita Sulejmani, në shumën 8.330.376 lekë, për periudhën 2006 — 2023.

Hetimi administrative:

Raiffeisen Bank me shkresën nr. ***prot., datë 8.5.2023, konfirmon llogari page në emër të Margarita Sulejmani, në të cilën kreditohen të ardhurat nga paga për periudhën 03.05.2006 — 28.2.2023, në shumën 18.732.66 lekë nga Policia e Shtetit dhe Drejtoria Arsimore, Vlorë.

ISSH me shkresë nr. ***prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Margarita Sulejmani ka përfituar të ardhura/neto nga paga, për periudhën 09.06.1983 — 26.12.1988 nga NB Vlora; për periudhën 26.06.1990 — 16.03.1991 nga NB Rinia, Vlorë; për periudhën janar 2012 — mars 2023, në shumën 5.630.821 lekë, nga Policia e Shtetit dhe Drejtoria Arsimore, Vlorë.

Konstatohet:

- ✓ **Trupa e vlerësimit ka konfirmuar nëpërmjet nxjerrjes së llogarive bankare faktin se të ardhurat e sipërpërmendura kanë qenë kreditime të pagës së personit të lidhur të vlerësimit ndër vite.**

DEKLARIM I DJALIT SË SUBJEKTIT BRUNO SULEJMANI
DEKLARIMI I PASURIVE

Pasuria nr. 1.

Automjet Ford Kuga, me targë AB***FL, nr. shasie ***, viti i prodhimit 2010. Blerë në datë 09.02.2022. Vlera 2.000 euro.

Burimi i krijimit: të ardhura nga paga dhe nga shitja e automjetit të mëparshëm, në datë 31.1.2022. Pronësia 100%.

Hetimi administrativ:

Raiffeisen Bank me shkresën nr. ***prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari page në emër të Margarita Sulejmani ku janë kredituar të ardhurat nga paga, me gjendje në shumën 358 lekë, datë 28.02.2023.

Pasuria nr. 2

Automjet Ford Kuga, me targë AB***FL, nr. shasie ***, viti i prodhimit 2010. Blerë në datë 09.02.2022. Vlera 2.000 euro. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga dhe nga shitja e automjetit të mëparshëm, në datë 31.1.2022. Pronësia 100%.

Hetimi administrativ:

DPSHTRR me shkresën nr. *** prot., datë 16.05.2022, konfirmon se Bruno Eduard Sulejmani ka të regjistruar mjetin me targë AB***FL.

Gjithashtu, ka patur në pronësi automjetet me targa AB *** FR, AA *** VI, AA *** SL, AA *** GV Eduard Sulejmën Sulejmani ka patur në pronësi automjetet me targa AA *** PH, AA *** ZO, AA *** DL. Bashkëlidhur:

- Dosja e mjetit, me targë AB***FI; dokument zhdoganimi datë 11.02.2022, për automjet tip Ford Kuga, nr. shasie ***, viti i prodhimit 2010, eksportuar nga Italia, vlera e automjetit 2.000 euro; shuma e paguar për zhdoganim 72.506 lekë.

➤ Dosja e mjetit me targë AA *** FR; Kontratë shitblerje automjeti, datë 06.11.2020, me blerës Bruno Sulejmani, për blerjen e automjetit me targë AA *** ZR (AB *** BS; AB *** FR), me çmim 700.000 lekë. Kontratë shitje pasurie e luajtshme nr. rep. *** , nr. kol. *** , datë 31.01.2022, me shitës Bruno Sulejmani, për shitje të automjetit me targë AB *** BS (AB *** FR), me çmim 7.500 euro.

➤ Dosja e mjetit, me targë AA *** VI; Kontratë shitblerje automjeti nr. rep. *** , nr. kol. *** , datë 6.11.2018, me blerës Bruno Sulejmani, për blerje të automjetit me targë AA *** SV, me çmim 3.800 euro. Kontratë shitje pasurie të luajtshme, datë 26.10.2020, me shitës Bruno Sulejmani, për shitje të automjetit me targë AA *** VI (AA *** SV), me çmim 8.500 euro.

➤ Dosja e mjetit, me targë AA *** ZO; Kontratë shitblerje nr. rep.** , nr. kol.** , datë 04.01.2017, me shitës Eduard Sulejmani, për shitje të automjetit me targë AA *** NA ,me çmim 6.000 euro. Faturë tatimore shitje nr. *** , datë 09.02.2016, me blerës Eduard Sulejmani, për kryerje të pagesës së blerjes së automjetit me nr. shasie *** (targë AA *** NA), në shumën 208.000 lekë.

➤ Dosja e mjetit me targë AA *** PH; leje qarkullimi e Eduard Sulejmani, për mjetin me targë AA *** PH, për v. 2017, 2020, 2021. Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.1.2017, me blerës Eduard Sulejmani, për blerje të automjetit me targë AA *** NE (AA *** PH), me çmim 200.000 lekë. Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 28.8.2017, me shitës Eduard Sulejmani, për shitje të automjetit me targë AA *** PH, me çmim 7.000 euro.

Kontratë shitje automjeti nr.rep.***, nr.kol. ****, datë 15.07.2013, me blerës Bruno Sulejmani, për blerje të automjetit me targë AA **** EI (AA *** GV), me çmim 1.000 euro. Kontratë shitje automjeti nr. rep.1101, nr.kol.***, datë 8.7.2016, me shitës Bruno Sulejmani, për shitje të automjetit me targë AA *** GV, me çmim 2.500 euro.

➤ Dosja e mjetit me targë AA *** DL; Kontratë shitje nr.**** rep., nr. *** kol., datë 9.1.2012, me blerës Eduard Sulejmani, për blerje të automjetit me targë CD *** (AA *** DL), me çmim *** euro. Kontratë shitblerje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9. 11. 2015, me shitës Eduard Sulejmani, për shitje të automjetit me targë AA *** DL, me çmim 6.700 euro.

➤ Dosja e mjetit me targë AA *** SL; Faturë tatimore shitje nr.****, datë 21.9.2017, me blerës Bruno Sulejmani, për kryerje të pagesës së blerjes së automjetit me nr.shasie *** , në shumën 444.000 lekë. Kontratë Shitje pasurie të luajtshme nr. **** rep., nr. *** kol., datë 04.06.2018, me shitës Bruno Sulejmani, për shitje të automjetit me nr. shasie *** , me çmim 6.500 euro.

Në procesverbalin e datës 13 qershor 2023,të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit në lidhje me shitjen e automjeteve me çmime më të larta se sa ai i blerjeve, subjekti shpjegoi se: “... në të gjitha rastet pasi i kanë blerë, kanë bërë një sërë rregullimesh, përmirësimesh dhe shërbimesh që kanë kushtuar dhe i kanë bërë automjetet më të sigurta dhe me pjesë këmbimi më të avancuara. Kështu, nuk kanë patur fitim real, pasi kanë kryer shpenzime për

këto shërbime. Këtë e provojnë edhe kontratat e shitblerjeve, të cilat janë hartuar para noterëve dhe po ashtu edhe blerësit...”

Në procesverbalin e datës 20.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti në lidhje me automjetin në pronësi të djalit Ford Kuga, me targë AB***FL, nr. shasie *** , viti i prodhimit 2010; blerë në datë 9.2.2022, me vlerë 2.000 euro, shuma e paguar për zhdoganim 72.506 lekë; **paraqiti:**

- Praktikën e plotë të zhdoganimit ku është pasqyruar pagesa e zhdoganimit në shumën 72.506 lekë e kryer nga ana e djalit të tij;
- Deklaratë doganore për automjetin tip Ford Kuga, me vlerë 2.000 euro.
- Certifikatë të pronësisë së mjetit me nr. shasie *** , dhe targë AB *** FL, në emër të Bruno Sulejmani.

Në procesverbalin e datës 29.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit përveç shpjegimit të dhënë në proces verbalin e mëparshëm, shtoi se “... nuk ka patur dijeni për detyrimin tatimor që duhet të paguante për diferencën e çmimit të shitjes me atë të blerjes së automjetit. As DPSHTRR dhe as noterët ku ka hartuar kontratat, nuk e kanë njoftuar për këtë detyrim. Por mund ta shlyejë detyrimin ndaj organeve tatimore, nëse i kërkohet një gjë e tillë. Përsa i takon blerësve të këtyre automjeteve, deklaroi se ata kanë qenë persona të rastësishëm, të cilët nuk kanë patur raporte profesionale, varësie ose bashkëpunimi; nuk kanë qenë subjekte të punës së policisë ose të kenë patur marrëdhënie interesi me të, familjen e tij dhe në asnjë rast me detyrën e tij...”

Nëpërmjet email-it të datës 14.07.2023, të dërguar pranë ILDKPKI dhe administruar nga trupa e vlerësimit subjekti ka paraqitur:

- Deklaratë Individuale Vjetore të të Ardhurave për periudhën tatimore 2022, me datë të deklarimit 14.07.2023, në të cilën janë deklaruar të ardhurat bruto nga punësimi dhe të ardhura të tjera të tatueshme;
- Faturë pagese nga Tirana Bank, për pagesë të kryer në datë 14.7.2023, të shumës 3.902 lekë, nga B. Sulejmani për Drejtorinë e Tatimeve.

Në procesverbalin e datës 28.08.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit në lidhje me shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për fitimin e realizuar nga shitja e automjeteve subjekti deklaroi se: “...pasi u vu në dijeni për këtë detyrim, do të kryej të gjitha pagesat përkatëse...”

Në procesverbalin e datës 14.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka paraqitur:

- Deklaratë Individuale Vjetore të të Ardhurave për periudhën tatimore 2021, në të cilën janë deklaruar të ardhurat bruto nga punësimi dhe të ardhura të tjera të tatueshme,
- Faturë pagese nga Tirana Bank, për pagesë të kryer në datë 30.8.2023, në shumën 35.250 lekë, me përfitues Drejtorinë e Tatimeve.

Në procesverbalin e datës 09.10.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti në lidhje me mos deklarimin e automjeteve që ka patur në pronësi dhe janë shitur gjatë viteve, sqaroi se *“...nuk e ka kuptuar që duhet t'i deklaronte. Ka menduar që duhej deklaruar çdo gjë që ka aktualisht në pronësi. Edhe në deklaratat e pasurisë që ka dorëzuar gjatë viteve në ILDKPKI, ka deklaruar rregullisht automjetin që ka patur në pronësi në secilin prej atyre viteve. Si burim për blerjen e automjeteve kanë qenë të ardhurat familjare....”*

Nëpërmjet email-it të datës 11.10.2023, të dërguar pranë ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti ka paraqitur

- Vërtetim nga shoqëria "Allidagu" shpk, sipas të cilit Bruno Sulejmani ka kryer shërbime periodike pranë kësaj kompanie, për automjetet me targa: AA *** BS, në periudhën 2020 – 2021, AA***VI për periudhën 2018 - 2020; AA *** NA, për periudhën mars — nëntor 2016, AA *** PH për periudhën mars — korrik 2017, AA *** DL, për periudhën 2012 - 2015, AA *** SL, për periudhën nëntor 2017 —prill 2018.

Me proces-verbalin e datës 12.10.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti sqaroi: *“... edhe një herë që ka shlyer detyrimin tatimor të vitin 2022 dhe ka paraqitur Deklaratë Individuale Vjetore të të Ardhurave për periudhën tatimore 2022, në të cilën janë deklaruar të ardhurat bruto nga punësimi dhe të ardhura të tjera të tatueshme (të krijuara nga shitje automjeti) si edhe faturë pagese nga Tirana Bank, për pagesë të kryer në datë 14.07.2023, të shumës 3.902 lekë, shumë e përcaktuar në Deklaratën Tatimore Individuale për viti 2022. 190 vlerë është paguar për të ardhurat e krijuara nga shitje automjeti...”*

Në lidhje me vlerat e shënuara në Deklaratën Vjetore të të Ardhurave Individuale të viti 2021, të paraqitur prej tij, sqaroi se *“...sipas informacionit të marrë në DR Tatimore Vlorë, vlera e përcaktuar në rubrikën: Të ardhura bruto të tjera të papërmendura më lart” është totali i shumës së shitjes së automjeteve, që ka patur familja e tij në pronësi në vite. Gjithashtu, theksoi se nuk ka patur të ardhura të Vera, përveç të ardhurave nga paga që i ka deklaruar dhe i vërtetohen edhe me dokumentet ligjore të dorëzuara...”*

Subjekti ka paraqitur:

- Vërtetim nr.516 prot., datë 12.10.2023, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Vlorë, sipas të cilit shuma prej 3.142.469 lekë, është deklaruar prej tij si vlerë e shumës së shitjeve totale të automjeteve në vite, që ka patur në pronësi ai dhe djali.

Trupa e Vlerësimit me email-in e datës 26.04.2024 dhe atë të datës 29.05.2024 ka pyetur subjektin e vlerësimit për mos deklarimin e këtyre pasurie si dhe për burimin e krijimit të kësaj pasurie si dhe me shpenzimet e kryera të cilat kanë pasjellë rritjen e vlerës së shitjes së këtyre makinave.

Subjekti i vlerësimit me email-in e datës 06.03.2024 ka sqaruar se: “...Lidhur me shpenzimet e kryera për makinat, nga ana ime dhe e djalit tim Bruno Sulejmani, nuk disponoj dokumente të veprimeve të kryera në vite, pasi këto janë kryer në mënyrë periodike në vite dhe kanë qenë punime të shkëputura në mjete, herë pas here sipas nevojave e mundësive ekonomike dhe nuk i është kushtuar rëndësia e duhur marrjes së faturave të pagesave të kryera.”

Gjithashtu deklaroi se “... Automjetit me targë AA *** NA, i kam vendosur goma të reja, si dhe larje tapicerie, vendosje e shtresave të brendshme të reja. Shpenzime këto në shumën 30.000 lekë. Automjetit me targë AA *** PH, i kam vendosur goma të reja, larje tapicerie, vendosje e shtresave të brendshme të reja, si dhe vendosje e shkallëve inoxi. Shpenzime këto në shumën 40.000 lekë

.Automjetit me targë AA *** SL, djali im Bruno Sulejmani, i ka vendosur goma të reja, si dhe larje tapicerie, vendosje e shtresave të brendshme të reja. Shpenzime këto në shumën 30.000 lekë.

Automjetit me targë AA *** SV(AA *** VI), djali im Bruno Sulejmani, i ka vendosur goma të reja, larje tapicerie, vendosje e shtresave të brendshme të reja, si dhe i ka dhënë pastë (shkëlqim) tapicerisë nga jashtë. Shpenzime këto në shumën 46.000 lekë...”

Konstatohet se:

Subjekti i vlerësimit ka paraqitur vërtetim të vitit 2023 nga shoqëria "Allidagu" shpk, sipas të cilit Bruno Sulejmani ka kryer shërbime periodike pranë kësaj kompanie, por nuk paraqet fatura mbi këto shërbime të kryera apo dokumentacion tjetër vërtetues sipas përcaktimeve ligjore.²

Pasuria nr. 3

Llogari page në Tirana Bank, me nr. *** EC. Pronësia 100%.

Hetimi administrativ:

Tirana Bank me shkresë nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon llogari page në emër të Bruno Sulejmani me gjendje në shumën 187 lekë, datë 28.02.2023.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

•Të ardhura nga paga, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Tiranë, në periudhën 24.10.2019 — 31.5.2022. Shuma mujore neto 59.112 lekë.

² Kodin Rrugore dhe aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij.

•Të ardhura nga paga, nga Gjykata e rrethit Gjyqësor, Vlorë, në periudhën 1.6.2022 — e në vazhdim. Shuma mujore neto 52.200 lekë.

Hetimi administrativ:

Raiffeisen Bank me shkresë nr. ***prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari page në emër të Bruno Sulejmani, në të cilën kreditohen të ardhurat nga paga për periudhën 04.11.2019 - 02.06.2022, në shumën 1.875.467 lekë.

Tirana Bank me shkresë nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon llogari page në emër të Bruno Sulejmani, në të cilën kreditohen të ardhurat nga paga për periudhën 05.07.2022 — shkurt 2023 në shumën 445.622 lekë, nga Gjykata e rrethit, Vlorë.

ISSH me shkresë nr. ***prot., datë 10.5.2023, konfirmon se Bruno Sulejmani ka përfituar të ardhura/neto nga paga, për periudhën janar 2019 — mars 2023.

Të ardhurat e djalit të subjektit nga paga dhe shpërblimet, për periudhën tetor 2019 — shkurt 2023, janë në vlerën totale rreth 2.321.000 lekë.

Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar deri në datë 28.02.2023, si më poshtë:
1. Sipërfaqe toke 5.790 m2, nga të cilat 4.250 m2 tokë arë, 820 m2 pemëtore dhe 720 m2 ullishte, në Orikum. Viti 1991. Burimi i krijimit: ligji nr.7501. Pronësia 20 %.
2. Sipërfaqe toke 5.000 m2, në Nartë, Vlorë. Marrë me qira për 99 vjet nga Komuna Qendër, Vlorë, në v.2008.
3. Apartament me sip. 74.28 m2, Lagjja "10 Korriku", rajoni nr.2, Vlorë. Vlera 40.000 euro.
4. Llogari në RFZ Bank, me gjendje në datën 28.2.2023, në shumën 69.950 euro. Pronësia 100%
5. Truall me sipërfaqe 640 m2 (1/3 pjesë e sipërfaqes prej 1.920 m2) në zonën Berdenesh Cukë, Sarandë. Vlera 512.000 lekë. Pronësia 33 %.
6. Llogari page në RFZ Bank, me gjendje në datën 28.2.2023, në shumën 64.187 lekë.
7. Bashkëshortja/ Llogari rrjedhëse në RFZ Bank, me gjendje në datën 28.2.2023, në shumën 1.546 lekë. Pjesa takuese 1000/0.
8. Djali/ Bruno Sulejmani/ Automjet Ford Kuga, me targë AB *** FL, blerë në datë 09.02.2022. Vlera 2.000 euro. Pronësia 100%
9. Djali/ Bruno Sulejmani/ Llogari page në Tirana Bank, me gjendje në datën 28.2.2023, në shumën 187 lekë. Pjesa takuese 100%.
10. Sipërfaqe toke 5.790 m2, nga të cilat 4.250 m2 tokë arë, 820 m2 pemëtore dhe 720 m2 ullishte, në Orikum. Viti 1991. Burimi i krijimit: ligji nr.7501. Pronësia 20 0/0.
11. Kredi në BKT, me gjendje të detyrimit në datë 28.2.2023, në vlerën 1.266.733 lekë.
Vlera e pasurisë bruto është 577.920 lekë + 111.950 Euro, e konvertuar rreth 13.486.000 lekë neto është 12.219.000 lekë.
<i>(Konvertuar me kursin e këmbimit të BSH të datës 28.02.2023, ku 1 Euro = 115.30 lekë)</i>

Hetimi administrativ:

✚ **Banka e Shqipërisë, Intesa Sanpaolo Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Procredit, Banka e Parë e Investimeve, Banka Credins, Banka Union, Baka OTP Albania, Raiffesien Bank, Porsche Leasing, Credins Invest, Fondi Besa, Institucioni Financiar NOA, Iutecredit Albania, Kredo Financë,** konfirmojnë se subjekti dhe bashkëshortja nuk janë klientë të tyre, çka konfirmohet me deklarinimin.

✚ **ASHK, zyrat/drejtoritë vendore, ZV Librazhd, ZV Mallakastër, ZV Devoll, DV Korçë, DV Fier, DV Berat, DV Lezhë, DV Lushnjë, DV Krujë, ZV Gramsh, DV Kucovë, ZV Pukë, ZV Malësi e Madhe, DV Kukës, DV Kavajë, ZV Bulqizë, DV Durrës ZV Skrapar, ZV Has ZV Kolonjë, DV Elbasan ZV Peqin, ZV Tropojë, DV Tepelenë, ZV Përmet, DV Tiranë Rurale 2, ASHK DV Zonat e Stimuluara, DV Kamëz, DV Rurale Tirana 1, ZV Mirditë ZV Mat, DV Gjirokastrë, DV Pogradec DV Shkodër, DV Dibër, DV Sarandë, DV Kurbin,** konfirmojnë se në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, nuk ka pasuri të regjistruara.

- **Raiffeisen Bank**, me shkresë nr. ***prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari për tërheqje Master Card, në emër të Eduard Sulejmani, me gjendje në shumën 17.86 euro, datë 28.02.2023. Llogari page në emër të Bruno Sulejmani, me gjendje në shumën 0 lekë, datë 28.02.2023.
- **BKT** me shkresë nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Bruno Sulejmani, me gjendje 0 lekë, në datë 28.02.2023; llogari rrjedhëse me gjendje 0 euro, në datë 28.02.2023.
- **Raiffeisen Invest**, me shkresë nr. *** prot., datë 11.05.2023, konfirmon se djali i subjektit, Bruno Sulejmani ka investuar në fondin RFZ Prestigj, nga data 07.05.2021 deri në datë 24.02.2022, në shumën totale prej 100.000 lekë. Vlera e tërhequr është 100.783 lekë.

Hetimi administrativ:

Në lidhje me këtë konstatim Trupa e Vlerësimit me email-in e datës 29.05.2024 është pyetur në lidhje me këtë konstatim .

Subjekti i vlerësimit me email-in e datës 03.06.2024 sqaron se : “...nga informacioni i marrë nga djali im Bruno Sulejmani, në lidhje me shumën 100.000 lekë, ju sqaroj se kjo shumë nuk është investim, por është Overdraft i marrë nga banka Raiffeisen Bank, në periudhën që ka qenë i punësuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor Tiranë, shumë e cila sipas marrëveshjes me bankën i është mbajtur çdo muaj nga paga mujore dhe likuiduar në afatin e caktuar.

Këtë nuk e kam deklaruar në formularin e deklaramit të pasurisë, në periudhën e deklaramit, pasi nuk kam patur dijeni për këtë veprim bankar, kryer nga djali im Bruno Sulejmani....”

Gjithashtu me emailin e datës 20.06.2024 subjekti ka paraqitur:

-Vërtetim nga Raiffeisen Bank për overdraftin me shumë 100.000 all me kontratë të datës 28.04.2021 është mbyllur në datën 01.03.2022.

- Nxjerrje llogarie Bruno Sulejmani për llogarinë rrjedhëse 0011436539-AL.

Konstatohet se:

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i vlerësimit me kthim përgjigjen e Raiffaisen Invest. .**

- **Unioni Financiar Tiranë**, me shkresë nr. 28/19 prot., datë 09.05.2023, konfirmon se në periudhën 28.04.2018 — 28.02.2023, Margarita Sulejmani ka kryer 1 transaksion nëpërmjet të cilit ka tërhequr shumën 200 euro; Bruno Sulejmani ka kryer 9 transaksione nëpërmjet të cilave ka tërhequr 1.042 euro; dhe 2 transaksione nëpërmjet të cilave ka dërguar 80 euro.
- **AK INVEST** me shkresë nr. 28/20 prot., datë 10.05.2023, konfirmon se Margarita Sulejmani ka kryer 3 transaksione, nëpërmjet të cilave ka tërhequr shumën: 1.000 euro, datë 13.05.2021; 150 euro, datë 18.11.2021; 170 euro, datë 29.04.2022, nga Leonora Jupe, Greqi. Bruno Sulejmani ka kryer 1 transaksion, nëpërmjet të cilit ka tërhequr shumën 700 euro, datë 9.9.2021, nga Jonida Rapushi, Shqipëri. Bashkëngjitur praktika.

Hetimi administrativ:

Në proces verbalin e datës 20.06.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe administruar nga Trupa e Vlerësimit subjekti në lidhje me transaksionet e kryera nga bashkëshortja dhe djali i tij nëpërmjet Ak Invest sqaroi se: “...bashkëshortja ka kryer veprime me motrën e saj që jeton në Greqi, dhe për këtë ka paraqitur certifikatën e përbërjes familjare të Qemal Shaban Qemali, lëshuar në datë 14.06.2023, nga Bashkia Vlorë, në bazë të regjistrit themeltar të vitit 1974, ku të dyja motrat janë të regjistruara si pjesë e trungut familjar. Ndërsa djali, ka kryer një transaksion me znj. Jonilda Rapushi, e Cila është e afërme e bashkëshortes së tij.

Në lidhje me veprimet e djalit me Unionin Financiar, sqaroi se personat me të cilët ka kryer veprime janë familjarë, që jetojnë jashtë vendit. Vërtetimet e detajuara për secilin veprim, të marrë nga Unioni Financiar, e ka dorëzuar në Protokollin e ILDKPKI.

Ka paraqitur.

- Vërtetim nr. *** prot., datë 16.6.2023, lëshuar nga Unioni Financiar Tiranë, sipas të cilit, bashkëshortja e subjektit, Margarita Sulejmani për periudhën 15 qershor 2018 — 14 qershor 2023, ka kryer 1 transaksion me Unionin Financiar, nëpërmjet të cilit ka tërhequr 200 euro.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 16.6.2023, lëshuar nga Unioni Financiar Tiranë, sipas të cilit, djali i subjektit, Bruno Sulejmani për periudhën 15 qershor 2018 — 14 qershor 2023, ka kryer 13 transaksione me Unionin Financiar, nëpërmjet të cilëve ka tërhequr 1.342 euro dhe ka dërguar 80 euro.
- ✚ **QKB** me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023, konfirmon se Eduard Sulejmani dhe personat e lidhur me të, nuk rezultojnë të jenë pajisur me NUIS si persona fizikë apo të zotërojnë aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrisë tregtare.
- ✚ **DPT**, me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të jenë regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.
- ✚ **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2023, konfirmon se nuk rezultojnë të regjistruara mjete lundruese në pronësi të subjektit.

✓ **Në përfundim të hetimit të kryer:**

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklaram i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit**

B. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe

identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit z.Eduard Sulejmën Sulejmani me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë së deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr.*** datë 23.10.2023 raportin e kontrollit të figurës³ ku ka konstatuar se:

✚ **Subjekti i vlerësimit z.Eduard Sulejmën Sulejmani, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit Vlorë, nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që të tregojnë se punonjësi kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar..**

³ Raporti mbi kontrollin e figurës nr.***** datë 23.10.2023

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që keni pasur apo keni regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale.
- Nuk është lëshuar ndonjëherë urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka asnjë dijeni se një nga anëtarët e familjes është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka patur asnjë kontakt të papërshtatshëm në formën e një takimi, komunikimi elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka patur asnjë kontakt të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka patur dijeni që një nga anëtarët e familjes ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar, shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasur me asnjë person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka patur dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE-së/Nato-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet tjetër.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

Hetimi administrativ:

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36 dhe 37, të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e tjera duke kërkuar të dhëna nga institucionet përgjegjëse, të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën nr.***. Prot, datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmën Sulejmani, bën me dije se:
 - Shtetasi Eduard Sulejmani , ka lindur në ZGJC Orikum-Vlorë, më datë 13.08.1964, në bazë të Aktit nr. *** , datë 28.08.1964, me të dhëna Eduard Sulejmani; atësia Sulejman dhe amësia Fiqirete.
 - Ka ndryshua emrin dhe mbiemrin nga Eduard Sulejmani në P.K., dhe më pas nga P.K në Eduard Sulejmani, me vendimin nr. *** , datë 09.05.1991, sipas regjistrat themeltar Orikum.
 - Në vitin 1995, transferohet, transferohet me leje banimi nga ZGJC Orikum në ZGJC-Rajoni nr.3 Vlorë, me të dhënat Eduard Sulejmani, atësi Sulejmën dhe amësi Fiqirete.(Sipas ZGJC Orikum transkriptim i gabuar i të dhënave të emrit dhe emrit të babait nga Eduard në Eduard dhe emri i babit nga Sulejman në Sulejmën).
 - Z. Eduard Sulejmani i datëlindjes 13.08.1964, me vendlindje Orikum, është banor që nga lindja. ZGJC Orikum, është banor që nga lindja. ZGJC Orikum regjistri Orikum nr.1, fleta 16, banor, i transkriptuar nga regjistrat para vitit 1974, përmirësim mbiemri familjarisht nga Sulejmëni në Sulejmani me vendim nr. 68, datë 19.08.2004, procesverbal ndryshimi nuk u gjet. Eduard Sulejmani transferuar në të njëjtin regjistër me nr. flete 25, vet i dytë, me këto të dhëna Eduard Sulejmëni i datëlindjes 13.08.1964, me vendlindje Orikum, ndërruar emri dhe mbiemrin më vendim nr. *** , datë 09.05.1991 nga Eduard Sulejmani në P.K , u gjet procesverbali bashkëngjitur shkresës. Kthim mbiemri në origjinë vendim nuk ka, transferuar vet i 3 në ZGJC nr.2 Vlorë me Akt. Nr. 68, datë 10.03.1995.

Nga verifikimet e kryera, nuk rezulton të ketë kryer ndryshime të tjera të gjeneraliteteve, ose lënie/marrje shtetësie.

Në lidhje më këtë konstatim Trupa e Vlerësimit me email-in e datës 26.04.2024 është pyetur nëse ka pasur ndryshim të gjeneraliteteve e nëse po përse nuk janë deklaruar në formularin e deklaramit të kontrollit të figurë.

Subjekti i vlerësimit më email-in e datës 03.06.2024 sqaron se : “ *Përpara se të filloja punë në Policinë e Shtetit, me mendimin për të emigruar, kam ndërruar emrin dhe mbiemrin për një*

periudhë kohore shumë të shkurtër, nga Eduard Sulejmani në P.K, si dhe e kam kthyer përsëri në gjendjen e mëparshme.

Këto ndryshime nuk i kam deklaruar në formularin e kontrollit dhe arsyeja e vetme është sepse pyetjen e kam kuptuar se duhet të deklaroja vetëm për periudhën qysh nga fillimi i marrëdhënieve në Policinë e Shtetit dhe jo edhe për periudhën e mëparshme....”

Në përfundim të analizës Trupa e Vlerësimit konstaton se subjekti i vlerësimit nuk ka deklaruar ndryshimet e gjeneraliteteve sipas detyrimeve ligjore në deklaratën e kontrollit të figurës. Si dhe i pyetur nga relatori i çështjes në email-in e datës 26.04.2024 ka deklaruar ndryshimin e gjeneraliteteve të vitit 1994 dhe nuk ka deklaruar ndryshimet e vitit 2004 duke qenë në kushtet e nenit 35 të ligjit nr.12/2018.

- **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve,** me shkresën nr. ***, Prot, datë 19.05.2023 dhe shkresa me nr. ***, datë 06.02.2024, për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmën Sulejmani, bën me dije se:
 - Nuk rezulton i dënuar.
- **Institucionet Ligjbatuese,** me shkresën nr. ***, prot, datë 30.05.2023 nr. ***, prot. datë 21.02.2023 ,. nr. ***, prot. datë 30.08.2023 informojnë se për subjektin e vlerësimit Eduard Sulejmani disponojnë informacione për kontakte me persona të dyshuar dhe apo të përfshije në veprimtari të kundërligjshme.
- **Institucionet Ligjbatuese,** me shkresën nr. ***, prot, datë 26.05.2023 nr. ***, prot. datë 30.05.2023 ,nr. ***, prot. datë 15.09.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmëni, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, **nuk kanë:**
 - Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në *krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”)* ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
 - Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*);

- Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
 - Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
 - Të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;
 - Të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet,
 - Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.
- **Institucionet Ligjzbatuese,** me shkresën nr. ***, prot, datë 01.06.2023, dhe me nr. ***, prot. datë 05.02.2024, informojnë se për subjektin e vlerësimit Eduard Sulejmani **nuk:**
 - Është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - Është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
 - Është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - Ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
 - Ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
 -
 - **Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes,** me shkresën nr.***. Prot, datë 31.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmani bën me dije se:
 - Nuk disponon të dhëna.
 - **Agjencia e Mbikëqyrjes Policore,** për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmani dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
 - Nuk kanë të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;

- Nuk ka procedime penale të referuara;
- Për subjektin e vlerësimit nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.
- **Prokuroria e Përgjithshme**, me shkresën nr.***. Prot, datë 27.06.2023, dhe me shkresën nr.***. Prot, datë 04.03.2024 për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmani, bën me dije se, **nuk:**
 - Është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - Është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
 - Është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - Ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale;
 - Ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave**, me shkresën nr.***. Prot, datë 19.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmani dhe personat e lidhur me të sipas certifikatës familjare, bën me dije se:
 - Rezultuan raportime lidhur për subjektin e vlerësimit z. Eduard Sulejmani sipas Aneks I, bashkëlidhur,
 - Nuk rezultuan raportime për personin e lidhur znj. Margarita Sulejmani.
- **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën nr.***. Prot, datë 19.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmani, bën me dije se:
 - Për Z.Eduard Sulejmën Sulejmani, AKSIK(DSIK), me shkresën nr.***prot., datë 31.01.2009, ka njoftuar Ministrin e Brendshme për refuzimin e pajisjes me CSP.
 - Agjencia e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. ***. prot., datë 02.03.2023, ka shprehur vlerësimin përkatës për Z. Sulejmani dhe aktualisht është ende në proces.

Në kuadrin e procedurave të verifikimit të sigurisë për pajisjen me CSP të subjektit Z. Eduard Sulejmani , për t'u njohur me informacionin e klasifikuar, struktura përgjegjëse është vënë në

dijeni të të dhënave referuese në ngarkim të tij, dhe ka kryer procedura verifikuese, në përfundim të të cilave ka rezultuar se nuk konfirmohet vërtetësia e tyre.

- **Avokati i Popullit**, me shkresën nr.***, Prot, datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmani, bën me dije se:
 - Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
 - Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.
- **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën, nr.***. Prot, datë 08.06.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Eduard Sulejmëni, bën me dije se:
 - Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, kolaudohet se subjekti vlerësimit **z. Eduard Sulejmani**:

Me shkresë nr. ***, prot., datë 11.01.2024, protokolluar me nr. ***, prot., datë 15.01.2024, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka dërguar dokumentacionin përkatës, analizuar dhe vlerësuar nga Trupa e Vlerësimit, konkretisht:

➤ Akt Ekspertimi Toksikologjiko – Ligjor nr. ***, datë 11.01.2024, për subjektin e vlerësimit Eduard Sulejmën Sulejmani

➤ Deklaratë Eksperti

Në bazë të rezultateve të përfituara nga ekspertiza toksikologjike për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se subjekti vlerësimit Z. Eduard Sulejmëni , aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

Denoncimet nga publiku

Denoncimet nga publiku Nga verifikimet e kryera nga Trupa e Vlerësimit, rezulton se nuk ka informacione të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin, veprimtarinë e subjektit të vlerësimit apo të personave të lidhur me të.

✚ Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Eduard Sulejmani, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Eduard Sulejmani

- *Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;*
- *Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

✚ Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, dërguar me shkresën nr. ***prot., datë 05.07.2023, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar

- ✚ Subjekti i vlerësimit **Z.Eduard Sulejmani** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e “Drejtor në Drejtorinë Vendorë për Kufirin dhe Migracionin, Vlorë.”
- ✚ Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit 12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shkrihet brenda këtij harku kohor.

Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës 2645/32 datë 30.06.2023 raportin e vlerësimit profesional është shprehur me Konkluzion përfundimtar si më poshtë vijon:

- ✚ **“Punonjësi i Policisë z.Eduard Sulejmën Sulejmani është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban”.**

- ✚ Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr.17759;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me nr. RMIS 9003098;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
- Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

- ✚ Punonjësi i Policisë, Kryekomisar Eduard Sulejmën Sulejmani është i emëruar në detyrë “Drejtor në Drejtorinë Vendorë për Kufirin dhe Migracionin, Vlorë.” me Urdhrin nr.1715, datë 02.08.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Eduard Sulejmani e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

- ✚ **Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi nivelin e arsimit në përputhje me nenin 43-45 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.**

✚ Bazuar në vetë deklarinimin e subjektit Eduard Sulejmani, janë marrë të dhënat si më poshtë:

1. Arsimi

Shkolla	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
Arsim i Lartë	Akademia e Rendit Publik	1994	1998	Tiranë	Diplomë
Arsim i Lartë	Universitetit i Tetovës, Fakulteti Juridik	2014	2018	Maqedoni	Diplomë Juristi

Trupa vlerësuese konstaton se,

- ✓ *Trupa e vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore administroj nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomën me nr.serie i diplomës 1234.*
- ✓ *Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.*

2. Ecuria në karrierë

Nga verifikimi i të dhënave të deklarinimit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Eduard Sulejmani ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 30 vitesh e 8 muaj. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare objekt deklarinimi, subjekti mban:

Institucionit ku punon/ka punuar	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Pozicioni
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë	03.08.2022		Vlorë	Drejtor
Reparti Special për Kufirin dhe	14.05.2019	02.08.2022	Vlorë	Komandant Reparti

Migracionin DELTA Vlorë				
Drejtoria Vendore e Policisë Berat	14.06.2018	16.05.2019	Berat	Drejtor

- **Gradën “Kryekomisar”**

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. Urdhrit	Data	
			Nga	Deri
Kryekomisar	Ngritur në gradë	Nr. 1 *** datë. 07.05.2010	12.05.2010	
Drejtues	Ngritur në gradë	Nr. 2367 datë 17.07.2024	01.06.2024	

Subjekti i vlerësimit në emailin e dërguar pranë Trupës vlerësuese ka sqaruar se ; “..Bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr. 195/13, datë 26.04.2024 ‘Për miratimin e listës të së drejtës për gradën “Drejtues”, ju bëj me dije se, jam shpallur fitues i gradës Drejtues..”

Trupa vlerësuese konstaton se:

- ✓ Subjekti i vlerësimit, Eduard Sulejmani është transferuar dhe emëruar në pozicionin aktual me Urdhër nr.1775, datë 02.08.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- ✓ Me urdhër nr. 2367 datë 17.07.2024, “Për dhënien e gradës policore dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, bazuar në ligjin nr.108/2014,i ndryshuar të Policisë së Shtetit dhe Rregullores së Policisë së Shtetit, të ndryshuar subjektit të vlerësimit i është dhënë grada policore “Drejtues”.
- ✓ Sipas deklarimeve të vetë subjektit dhe vërtetimeve që ka sjellë, ai ka një karrierë në Policinë e Shteti rreth 30 vite e 8 muaj.

3. Trajnime / Kualifikime

- ✚ Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale , pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe verifikimeve në sistemin RMIS, subjekti për periudhën e përcaktuar në ligjin 12/2018, i ndryshuar nuk ka kryer trajnime.

4. Vlerësimet e Punës.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale , pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe verifikimeve në sistemin RMIS, subjekti për periudhën 2018-2023 objekt verifikimi ka rezultuar:

Bazuar në informacionin e marrë nga institucionet lidhur me “Vlerësimin e rezultateve individuale të punës”, sipas viteve ka rezultuar si më poshtë:

- | | | |
|---|---------|------------|
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018 | 28 pikë | Shumë mire |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 | mungon | |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 | mungon | |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 | 26 pikë | |
| • Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 | 96 pikë | Shumë mire |

Gjendur në këto kushte Trupa e vlerësimit me email-in e datës 19.06.2024 ka pyetur subjektin e vlerësimit në lidhje me mungesën e vlerësimeve të punës.

Subjekti i vlerësimit me email-in e datës 20.06.2024 ka paraqitur :

- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021

Trupa e vlerësimit gjatë hetimit të zhvilluar, ka konstatuar se nuk është e mundur të disponohen vlerësime pune për periudhën 5-vjeçare të vlerësimit sipas nenit 44 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, për arsyen se nuk rezultojnë të administruara në dosjen e personelit dhe as subjekti i vlerësimit nuk i disponon.

5. Masa Disiplinore

Nga verifikimet në dosjen personale si dhe në sistemin RMIS, rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit, nuk është ndëshkuar disiplinarisht me masë disiplinore.

Trupa e vlerësimit konstaton se subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.

✚ Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi ecurinë në karrierë të subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43-45 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

✚ Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Eduard Sulejmani :

- ✓ **Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

Konkluzione përfundimtare:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 02.02.2024, ftoj subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 22.02.2024, dhe arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Eduard Sulejmën Sulejmani , në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;**
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;**
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.**

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit Eduard Sulejmani me funksion Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Vlorë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim u shpall sot datë 26.09.2024, në Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë 26.09.2024.

KRYESUES

KLEADA MERSINLLARI

RELATOR

EDONA DUSHAJ

ANËTAR

ENTON RADOVANI